



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D

# - BULETINI

nr. 13 • Viti X, 2017



# PËRMBAJTJA

- 1 Mbahet edicioni i dytë i Forumit të Nivelit të Lartë për Energji "Strategjia e Energjisë dhe Liberalizimi I Tregut"
- 2 KOSTT nikoqir i takimeve regjionale të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Evropës Juglindore
- 3 Projekti për përmirësimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike faza IV dhe V, drejt përfundimit
- 4 KOSTT realizon vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Sllovenisë – ELES
- 5 KOSTT merr pjesë në Konferencën Rajonale të ENTSO-E "Pjesëza e fundit e mozaikut: Integrimi i Evropës Juglindore në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike
- 6 KOSTT pjesë e delegacionit në takimin e parë të MSA-së, Grupi i Veçantë për normalizim në Bruksel
- 7 Fillimi i implementimit të mekanizmit balancues në KOSTT
- 8 Komisioni parlamentar për zhvillim ekonomik diskuton rreth sfidave me të cilat përballet KOSTT në integrimin në mekanizmat ndërkombëtar
- 9 Menaxhmenti i KOSTT priti në takim përfaqësuesit e lartë të Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- 10 Kosova dhe Shqipëria njoftohen me praktikatat e Austrisë dhe Gjermanisë në organizimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike
- 11 Menaxhmenti i KOSTT zhvillon takimet përgatitore për implementimin e projekteve që bashkëfinancohen me BERZH
- 13 Delegacioni i KOSTT realizon vizitë pune në OST Shqipëri
- 13 KOSTT ndan mirënjohje për komunat që kanë kontribuar në implementimin e projekteve për zhvillimin e Sistemit Transmetues të Kosovës
- 14 Fillon zbatimi i prokurimit elektronik në KOSTT sh.a.
- 15 KOSTT realizon vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Kroacisë – HOPS
- 16 Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Buletini nr.13, Viti X, 2017

Buletini është publikim i KOSTT sh.a

Rr. Isa Boletini, Nr. 39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381(0) 38 501 301 174 ; email: [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)

Web: [www.kostt.com](http://www.kostt.com)

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zyrën për Komunikim dhe Relacione me Publikun në:

[zana.rama@kostt.com](mailto:zana.rama@kostt.com) ose [info@kostt.com](mailto:info@kostt.com)



## Mbahet edicioni i dytë i Forumit të Nivelit të Lartë për Energji "Strategjia e Energjisë dhe Liberalizimi i Tregut"

**N**ë Forumin e Nivelit të Lartë për Energji që u organizua për të dytin vit radhazi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe USAID u diskutua mbi Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026 si dhe për liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë. Në Forum i cili u mbajt me 18 prill 2017 në Prishtinë ku morën pjesë udhëheqësit më të lartë qeveritarë, përfshirë Kryeministrin e Kosovës z.Isa Mustafa, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik z.Blerand Stavileci, të pranishëm ishin edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës z.Greg Delawie, drejtori i zyrës së Bankës Botërore z.Marco Mantovanelli, përfaqësuesi i zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë z.Luigi Brusa, përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe IFC/NordPool, si dhe akterë të tjerë të sektorit të energjisë vendorë dhe ndërkombëtar. Në prezantimin e mbajtur nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani, audienca u njoftua në lidhje me gjendjen aktuale të Sistemit Transmetues të Kosovës, ndikimin e investimeve të vazhdueshme



në zhvillimin e rrjetit të transmisionit dhe në ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmetimit, përgatitjet e nevojshme për procesin e liberalizimit të tregut si dhe obligimet që dalin për KOSTT-in nga



Strategjia e re e Energjisë 2017-2026 e cila tashmë është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe pritet që së shpejti të miratohet edhe në Kuvend. Një nga çështjet e rëndësishme të cilat i adresoi z.Hasani ishin sfidat nëpër të cilat po kalon KOSTT si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes për Kyçje KOSTT-ENTSO-E me të cilën KOSTT bëhet zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Europës Kontinentale. Me këtë rast z.Hasani shprehu shqetësimin për bllokimin e implementimit të Marrëveshjes për Kyçje nga ana e Serbisë si dhe bëri thirrje për përkrahje nga autoritetet vendore dhe ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së pavarësisht të KOSTT pasi që kjo pengesë po i shkakton KOSTT-it ngecje në zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe përmbushjen e obligimeve karshi proceseve regjionale dhe obligimeve nga Traktati i Komunitetit të Energjisë për Evropën Jug-lindore. Në kuadër të Forumit, menaxheri i planifikimit afatgjatë në KOSTT z.Gazmend Kabashi, njëherit anëtarë i grupit punues për hartimin e Strategjisë së Energjisë 2017-2026, prezantoi aspektet teknike të skenarëve të gjenerimit në kuadër të strategjisë.

Pjesë e forumit "Strategjia e Energjisë dhe Liberalizimi i Tregut" ishin edhe dy fokus grupe, ai mbi zhvillimet aktuale dhe të ardhshme të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë si dhe fokus grupi për liberalizimin e tregut ku drejtori i operimit të tregut në KOSTT z.Skender Gjonbalaj mbajti një prezentim rreth operimit të tregut të energjisë dhe implementimit të mekanizimit balancues në Sistemin Transmetues të Kosovës.

Në kuadër të Forumit, zv.Kryeshefi i KOSTT z.Kadri Kadriu zhvilloi një takim me palët

relevante të interesit nga Kosova dhe Shqipëria ku u diskutua rreth progresit në themelimin e bursës shqiptare të energjisë (APEX), si dhe bashkërendimin e aktiviteteve për përfshirjen e Kosovës në kuadër të bursës shqiptare të energjisë.



## KOSTT nikoqir i takimeve regjionale të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Evropës Juglindore

**N**ën organizimin e KOSTT sh.a në Prishtinë, u mbajtën punimet e takimit të 22të të Bordit të Drejtorëve të Zyrës për Alokim të Kapaciteteve Interkonektive për Evropën Juglindore (SEE CAO) si dhe takimit të 21të të Grupit rajonal të vendeve të Evropës juglindore të rrjetit evropian të OST-ve (RG SEE).

Në fjalën e tij të rastit, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani u shprehu mirëseardhje në Prishtinë përfaqësuesve të OST-ve pjesëmarrëse dhe shprehu nderin dhe kënaqësinë që KOSTT është nikoqir i këtyre dy takimeve regjionale shumë të rëndësishme. Me këtë rast, z.Hasani i njoftoi të pranishmit me të arriturat e KOSTT si dhe me pengesat me të cilat

përballet Kosova në integrimet rajonale dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike.

KOSTT është një nga themeluesit e Zyrës rajonale për alokim të koordinuar të kapaciteteve transmetuese interkonektive – SEE CAO me seli në Podgoricë. Themelimi i kësaj Zyre është një hap drejt krijimit të tregut të përbashkët rajonal dhe integrimit në tregun unik Evropian, dhe në anën tjetër, ofron Kosovën në përmbushjen e obligimeve të marra në kuadër të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë për EJL dhe procesit të integrimit në BE. Ndërsa RG SEE është grup regjional në ombrellën e Komitetit të tregut të rrjetit evropian të OST-ve të, i cili merret me çështjet e tregut në EJL.





## Projekti për përmirësimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike faza IV dhe V, drejt përfundimit

**I**mplementimi i investimit në vlerë të përgjithshme prej afër € 33 milion për përmirësimin e infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë, Faza IV dhe V, po i afrohet finalizimit. Një pjesë e theksuar e pakos së projekteve në kuadër të fazës IV dhe V kanë përfunduar sipas afatit të paraparë kontraktual, gjegjësisht më herët se që është paraparë me kontratë si rezultat i angazhimit maksimal nga ekipet punuese dhe menaxhuese si dhe implementuesit e projekteve.

Gjatë muajit dhjetor 2016 janë lëshuar në punë:

- linja e dyfishtë e tensionit të lartë 110 kV që lidhë Nënstacionet Peja 1 me Peja 3 me gjatësi të

përgjithëshme prej 26 km, nga e cila 24 km linjë ajrore dhe 2 km linjë kabllore nëntokësore. Kjo njëherit përbën linjën e parë nëntokësore të



tensionit të lartë 110 kV në Kosovë. - zëvendësimi i përçuesve mbrojtës në linjat transmetuese interkonektive me kablllo optike – OPGW në gjatësi totale rreth 54 km. -sistemi i stabilimenteve të teknologjisë moderne GIS (Gas Insulated Switchgear) në NS Peja 1. -është instaluar dhe energjizuar transformatori i dytë me fuqi 300 MVA në Nënstacionin 400/110 kV Peja 3-është instaluar dhe energjizuar transformatori i dytë me fuqi 300 MVA në Nënstacionin 400/110 kV Ferizaj 2.

Implementimi i projekteve në fjalë po mundësohet përmes kredisë komerciale afatgjate që KOSTT sh.a e ka siguruar nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) me kushte kredituese të buta në vlerë prej € 23,5 milion, financimin shtesë në formë granti nga

Komisioni Evropian në vlerë prej € 7.3 milion përmes programit IPA dhe 2.1 milion nga buxheti I KOSTT.

Implementimi i projekteve në kuadër të fazës IV dhe V ka një impakt të madh në rritjen e stabilitetit dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit dhe krijon mundësi për zhvillimin ekonomik dhe të potencialit të turizmit për rajonin e Pejës, Istogut dhe Ferizajit. Projekti "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, Programi IV dhe V i Sektorit", përbëhet nga 4 (katër) LOT-e:

**LOT 1: Nënstacionet** - i cili po implementohet nga kompania austriake SIEMENS (Austri)

**LOT 2: Transformatorët** – i cili po implementohet nga kompania kroate Konçar Power Transformers

**LOT 3: Linjat e Transmisionit** – i cili po implementohet nga kompania kroate Dalekovod (Zagreb)

**LOT 4: Rehabilitimi i 19 nënstacioneve** – i cili po implementohet nga kompania SIEMENS (Austri)

Finalizimi i përgjithshëm i projekteve në kuadër të fazës IV dhe V pritet të kompletohen nga mesi i vitit 2017.



## KOSTT realizon vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Sllovenisë – ELES



**M**e qëllim të shkëmbimit të përvojave për operimin e tregut të energjisë elektrike, nga data 22 deri 24 Mars 2017, KOSTT realizoi një vizitë studimore në kompaninë homologe të Sllovenisë, ELES. Në kuadër të kësaj vizite e cila u organizua nga projekti i USAID (Repower Kosova), u realizua takimi në mes të delegacionit të KOSTT i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv, z. Mustafë Hasani dhe përfaqësuesve të ELES në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Aleksandar Mervar.

Meqenëse në Kosovë nga data 1 prill 2017 do të bëhet hapja e tregut të energjisë elektrike si dhe në muajt në vijim do të fillojë implementimi i mekanizimit balancues kjo vizitë është shfrytëzuar për shkëmbim të përvojave në implementimin e mekanizimit balancues si dhe proceseve në operimin e sistemit transmetues dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Me homologët nga Sllovenia, gjithashtu u diskutua edhe për sfidat me të cilat po përballet KOSTT për fillimin e implementimit të Marrëveshjes për Kyçe me ENTSO-E me ç'rast u kërkuar përkrahja e KOSTT në këtë drejtim.

Në përmbyllje, z. Hasani në emër të KOSTT ka shprehur falënderim për pritjen e ngrohtë dhe gatishmërinë për përkrahjen si dhe shprehur falënderim të posaçëm për z. Faruk Serdarevic nga AECOM – REPOWER, për organizim të shkëlqyeshëm të kësaj vizite studimore.






## KOSTT merr pjesë në Konferencën Rajonale të ENTSO-E "Pjesëza e fundit e mozaikut: Integrimi i Evropës Juglindore në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike"

**M**enaxhmenti i KOSTT sh.a mori pjesë në Konferencën Rajonale për Evropën Juglindore të Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (ENTSO-E), të titulluar "Pjesëza e fundit e mozaikut: Integrimi i Evropës Juglindore në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike", gjatë muajit nëntor 2016.

Në suaza të konferencës u mbajt edhe takimi i nivelit të lartë të drejtorëve të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (OST) të EJK ku u diskutua për objektivat dhe sfidat për funksionalizimin e tregut të energjisë elektrike në Evropën Juglindore. Në këtë takim KOSTT paraqiti progresin e arritur deri më tani si dhe sfidat me të cilat po përballë si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes së Kështjës KOSTT – ENTSO-E, me të cilën parashihet që KOSTT të filloj operimin si zonë/bllok i pavaruar kontrollues.

Në kuadër të konferencës, zv.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Kadri Kadriu prezantoi para të pranishmëve rolin dhe ndikimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në ngritjen e sigurisë së operimit të sistemit rajonal, mundësitë e krijimit të tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri si dhe integrimin e tij

më tutje në rajon. Me këtë rast, z.Kadriu gjithashtu foli edhe për pasojat e mos implementimit të Marrëveshjes për Kështjën KOSTT-ENTSO-E dhe ndikimin në mos-funksionalizimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri, shqetësimin për mos vënien në operim të së cilës e shprehu edhe Ministri i Energjisë së Shqipërisë z. Damian Gjoknuri, gjatë fjalës së tij. Gjithashtu, menaxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, kanë zhvilluar një varg takimesh konsultative me homologët nga rajoni dhe zyrtarët e ENTSO-E në mesin e të cilëve me Presidentin z.Peder Adreasen



znj.Bente Hagem-Kryetare e Bordit ENTSO-E, z.Janez Kopač-Drejtor i Sekretariatit të Energjisë për EJJL, ku janë diskutuar tema me interes për KOSTT.

Ndërsa, në vazhden e angazhimeve të KOSTT për integrim në mekanizmat evropian, me datë 17 mars 2017 delegacioni i KOSTT realizoi një takim joformal me zyrtarët e ENTSO-E Jenz Birkebaek – kryesues i Grupit Regjional për Evropën Kontinentale dhe Alexander Mondovic –këshilltar në Sekretariatit të ENTSO-E. Në këtë rast, u diskutua për mundësitë e fillimit të operimit të KOSTT si zonë/bllok i pavarur kontrollues dhe zhbllokimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT – ENTSO-E. Në takim, menaxhmenti i KOSTT ripërsëriti kërkesën për fillimin e operimit si zonë/bllok i pavarur kontrollues gjë që do të mundësonte zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe përmbushjen e obligimeve të KOSTT karshi proceseve regjionale dhe obligimeve nga Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë për Evropën Jug-lindore.

Zyrtarët e ENTSO-E në anën tjetër kanë theksuar që po shqyrtohen mundësitë për zhbllokimin e Marrëveshjes për Kyçe KOSTT-ENTSO-E për ti mundësuar KOSTT-it fillimin e operimit si zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Europës Kontinentale.



## **KOSTT pjesë e delegacionit në takimin e parë të MSA-së, Grupi i Veçantë për normalizim në Bruksel**

**M**e datë 21 mars 2017 në Bruksel, delegacioni i Republikës së Kosovës nën udhëheqjen e Ministres për Dialog znj.Edita Tahiri, mbajti takimin e parë të Grupit të veçantë për normalizim në kuadër të Stabilizim Asocimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës.

Në takim u bisedua rreth progresit dhe sfidave në implementim të Marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të Brukselit në mes të Kosovës

dhe Serbisë, ku ndër të tjera është edhe Marrëveshja për Energji, e cila është në pritje të zbatimit.

Në takimin e parë të Grupit të Veçantë për normalizim, i cili rrjedh si obligim nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim në mes të Kosovës dhe BE-së, pjesë e delegacionit të Kosovës ishte edhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani.



## Fillimi i implementimit të mekanizmit balancues në KOSTT



**P**olitikat moderne liberale në Evropë, të mbështetura me rregullore dhe direktiva, imponuan krijimin e tregut rajonal të energjisë, fleksibil ndaj integritimit në tregun e brendshëm Evropian dhe funksionimin e tij mbi një kornizë të vetme rregullative dhe ligjore.

Gjashtë Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia janë zotuar për zbatimin e të ashtuquajturat "masa të buta të energjisë", në nivel kombëtar dhe rajonal. Në përmbushjen e zotimeve të gjashtë shteteve të Ballkanit, e njohur si iniciativa e WB6 për themelimin e tregut të organizuar (spot market), tregut rajonal balancues dhe alokimit rajonal të kapaciteteve interkonektive, KOSTT nuk mund të plotësojë kërkesat pasiqë i është pamundësuar të zbatojë marrëveshjen e nënshkruar me ENTSO-E dhe të veprojë si Zonë tregtare<sup>1</sup>. Por, pavarësisht pengesave

"politike", KOSTT po bën të gjitha përgaditjet e duhura në mënyrë që të jetë plotësisht i gatshëm për integrimin në mekanizmat rajonal.

Dizajni i Tregut të energjisë elektrike të Kosovës paraqet një treg bilateral të shoqëruar me një mekanizëm balancues në të cilin KOSTT, pranon oferta për blerje dhe shitje të energjisë për të menaxhuar diferencat e rrjedhave të cilat nuk janë të mbuluara me kontrata bilaterale. Ky mekanizëm balancues do të funksionojë mbi parimet e tregut dhe do të sigurojë balancimin e sistemit në kohë reale.

Ligji i miratuar për Energjinë elektrike<sup>2</sup> përcakton obligimin e TSO të prokurojë shërbimet balancuese në një procedurë transparente, jodiskriminuese bazuar në treg. Operatori i Tregut ka zhvilluar "Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit të Jobalancit dhe Çmimit të Kompensimit"<sup>3</sup>. Nga 1 tetor 2016, KOSTT ka filluar fazën testuese të mekanizmit balancues pa ndikim financiar (dry-run). Mekanizmi balancues implementohet/operohet nga Operatori i Sistemit kurse rregullat dhe funksionimi komercial, duke përfshirë kalkulimin e jo balanceve, i këtij mekanizmi është përgjegjësi e Operatorit të Tregut. Të gjithë pjestarët e tregut, me skedulime të regjistruara te OT, janë pjesë e mekanizmit balancues dhe janë përgjegjës për jobalancet që i shkaktojnë. Devijimi nga pozita e tyre e nominuar i bën ata përgjegjës për pagesën e çmimit të jobalancit i cili duhet të jetë në proporcion me kostot e balancimit.

Nga ana tjetër, Palët Tregtare, do të mund të dorëzojnë te OT ofertat e tyre për ngritje/zbritje në përputhje me të cilat ata pranojnë të ndryshojnë nominimet e tyre fizike, nëse kërkohet nga OS.

Me fillimin e implementimit të mekanizmit balancues pagesa mujore mes palëve bëhet në bazë të vlerave të nominuara dhe të aprovuara nga KOSTT. Operatori i tregut nga 1 tetor 2016 ka filluar me fazën testuese të mekanizmit balancues pa implikim financiar. Sipas rekomandimeve të ZRrE-së, kjo fazë "dry run" do të vazhdojë deri më 31 maj 2017.

*Vjosa Rezniqi*

*Menaxhere e Sektorit të Operimit të Tregut*

<sup>1</sup> Për këtë arsye MZHE, ZRRE dhe KOSTT më 27 prill 2016 nuk kanë nënshkruar MeM të, WB6 qëllimi i të cilit është integrimi i plotë i tregut të energjisë elektrike dhe siguria e furnizimit në WB6, si një hap i parë drejt tregut rajonal të energjisë elektrike në gjithë rajonin e EIJL.

<sup>2</sup> LIGJI Nr. 05/L - 085

<sup>3</sup> Dokumenti është aprovuar nga ZRRE më 14.10.2016 (V\_853\_2016)

## Komisioni parlamentar për zhvillim ekonomik diskuton rreth sfidave me të cilat përballet KOSTT në integrimin në mekanizmat ndërkombëtar

**K**omisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në takimin që mbajti me datë 7 mars 2017, diskutoi rreth sfidave me të cilat po përballet KOSTT në proceset e integrimi rajonale dhe evropiane. Në këtë takim, Ministria për Dialog znj. Edita Tahiri ka dhënë më shumë detaje për deputetët e Kuvendit të Kosovës në lidhje me moszbatimin e Marrëveshjes për Energji nga ana e Serbisë, dhe pengesave që po i bëhen KOSTT-it nga ana e Serbisë për të filluar me implementimin e Marrëveshjes për Kycje me ENTSO-E që i mundëson KOSTT-it operimin si zonë/blok kontrollues i pavarur.

Anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, kanë shprehur shqetësimin e tyre për mos zbatimin e Marrëveshjes për Energji nga ana e Serbisë si dhe kanë sygjëruar që të merren masa konkrete për të ndikuar në zbatim të marrëveshjes. I pranishëm në këtë takim ishte edhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani, i cili i informoi deputetët e Kosovës në lidhje me obstrukcionet e operatorit të transmisionit të Serbisë (EMS) si dhe dëmet financiare që po i

shkaktohen KOSTT-it si pasojë e këtyre interferimeve.

Ndryshe, në vizitën që e kishte realizuar ky komision parlamentar në KOSTT para disa muajsh. Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik z. Muhamet Mustafa, shprehu mirënjohje për punën që po zhvillohet në KOSTT e cila ka dhënë rezultate të prekshme si në uljen e humbjeve në rrjetin transmetues që njëherit përbëjnë humbjet më të ulta në rajon, ashtu edhe me investimet prej afro 200 milion euro që janë realizuar për 10 vite që nga themelimi i KOSTT. Me këtë rast, z. Mustafa duke potencuar rolin e rëndësishëm që ka KOSTT në Sistemin Elektroenergetik të Kosovës, ndër të tjera theksoi "Ju mbështesim në punën që e keni bërë dhe ju inkurajoj që të vazhdoni të thëlloni tutje rezultatet". Kjo vizitë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës në KOSTT u realizua në dritë të miratimit të ligjit të ri për energjinë elektrike, sipas të cilit të drejtat e aksionarit për KOSTT do të ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës.





## Menaxhmenti i KOSTT priti në takim përfaqësuesit e lartë të Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

**M**enaxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani në muajit shkurt 2017 pritën në takim delegacionin e lartë të Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) udhëhequr nga drejtori për energji dhe infrastrukturë për Evropë dhe Eurazi z.Steve Burns si dhe z.William Trigg zv.drejtor në zyrën për rritje ekonomike dhe z.Arben Nagavci,



specialist për menaxhim të projekteve. z.Hasani, e njoftoi delegacionin amerikan lidhur me progresin në integrimin e tregut të energjisë Kosovë-Shqipëri dhe pjesëmarrjen e KOSTT në bursën shqiptare të energjisë, si faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin e të dyja vendeve dhe sjellin benefite të ndërsjella në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Delegacioni i USAID gjithashtu u njoftua edhe për sfidat me të cilat po përballet KOSTT në proceset e integrimi në mekanizmat rajonale dhe evropiane. Me këtë rast, z.Burns vlerësoi angazhimet dhe punën që po bëhet në KOSTT si dhe e konsideroi KOSTT-in storie të suksesit në Kosovë. z.Burns gjithashtu njoftoi që USAID planifikon edhe më

tutje të suportoje KOSTT-in në drejtim të reformave dhe integritit të tregut të energjisë elektrike të Kosovës. Ndryshe, gjatë muajit shtator 2016, KOSTT është vizituar edhe nga një delegacion i Departmentit të Shtetit (SHBA) udhëhequr nga znj. Mary Burce Warlick - Zëvendës Ndihmëse e Parë e Sekretarit të Shtetit për Energji, ku janë njoftuar me sfidat e fillimit të operimit të pavarur të KOSTT si zonë/blok rregullues si dhe pjesëmarrjen e KOSTT në mekanizmat regional të transmisionit të energjisë elektrike, si dhe për punën dhe angazhimin e KOSTT në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike karshi obligimeve të iniciativës së WB6 apo të ashtuquajturit Procesit të Berlinit.



Me këtë rast, znj. Warlick njohu sfidat me të cilat po përballet KOSTT dhe shprehi mbështetjen e Departamentit të Shtetit - Byrosë për Energji për angazhimin që po bën KOSTT si dhe për fillimin e operimit të pavarur si zonë/blok rregullues dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

## Kosova dhe Shqipëria njoftohen me praktikat e Austrisë dhe Gjermanisë në organizimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike

**N**ë kuadër të përkrahjes nga projekti i USAID (RePower) për themelimin e tregut të përbashkët të energjisë Kosovë-Shqipëri, përfaqësues të ministrive përkatëse, autoriteteve rregullatore të energjisë dhe Operatorët e Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) dhe Shqipërisë (OST), realizuan një vizitë zyrtare në OST-në e Austrisë në Vjenë (Austrian Power Grid) dhe në TSCNET (TSO Security Cooperation Center) në Mynhen të Gjermanisë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me praktikat dhe me eksperiencën e shtetit të Austrisë dhe të Gjermanisë në bashkimin e tregut të energjisë elektrike dhe funksionimin si një zonë e vetme tregtare dhe mundësia e aplikimit të këtij modeli për themelimin e një zone të vetme operuese, tregtare dhe balancuese të energjisë elektrike Kosovë- Shqipëri. Delegacionet gjithashtu u njoftuan edhe me praktikat e qendrës koordinative të kontrollit të sigurisë për menaxhimin e

kapacitetit ndërkufitar dhe ridispeçimit të energjisë elektrike në raste të kongestionëve. Në këtë vizitë, delegacioni i KOSTT u kryesua nga Kryeshefi Ekzekutiv (KShE) z.Mustafë Hasani, dhe ishte në përbërje të z.Kadri Kadriu zv.KShE, z.Skender Gjonbalaj-Drejtor i operimit të tregut, z.Sabri Musiqi-Drejtor i operimit të sistemit dhe zyrtarë të tjerë të fushës. Kosova dhe Shqipëria, gjatë vitit 2016 kanë intensifikuar angazhimet në drejtëm të integritimit të plotë të tregut të energjisë elektrike si dhe bashkëpunimin në krijimin dhe operimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (APE) në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore (SKE). Në kuadër të kësaj vizite u realizua edhe një vizitë në Sekretariatit të Energjisë për EJJL në Vjenë ku u diskutua rreth bashkëpunimit të ndërsjellë dhe çështjeve në interes të zhvillimit dhe funksionimit të tregut të energjisë elektrike.





## Menaxhmenti i KOSTT zhvillon takimet përgatitore për implementimin e projekteve që bashkëfinancohen me BERZH

**N**ë kuadër të angazhimeve përgatitore të menaxhmentit të KOSTT për fillimin e implementimit të projekteve, në vlerë të përgjithshme prej € 36.5 milion, të bashkëfinancuara me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), janë realizuar takime me Kryetarët e Komunave, të cilat do të përfitojnë nga ky investim kapital.

Në takimet e realizuara ndaras me kryetarët e komunave të Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Rahovecit dhe Therandës, nga menaxhmenti i KOSTT u njoftuan në lidhje me planet për zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit të transmisionit, në mbështetje të rritjes së sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpër komunat respektive, si një nga parakushtet kyçe për zhvillim ekonomik.

Në anën tjetër, të gjithë kryetarët e komunave kanë shprehur mirënjohje për KOSTT për realizimin e investimeve të planifikuara si dhe njëkohësisht kanë shprehur zotimin për gatishmëri në dhënien e përkrahjes në proceset përgatitore si dhe gjatë procesit të realizimit të projekteve.

Në kuadër të këtyre projekteve që parashihen të fillojnë zbatimin nga mesi i këtij viti, hyjnë:



Komuna e Prishtinës – Ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/10(20) kV - Prishtina 6 me sistemin e stabilimenteve të teknologjisë moderne GIS, instalimi i 2 transformatorëve energjetikë me fuqi nga 40 MVA dhe ndërtimi i linjës së dyfishtë kabllorike nëntokësore të tensionit të lartë 110 kV me gjatësi prej 3.8 km nga NS Prishtina 6 në NS 220/110 kV – Prishtina 4.



Komuna e Fushë Kosovës- Ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/10(20) kV – Fushë Kosovë me sistemin e stabilimenteve të teknologjisë moderne GIS, instalimi i 2 transformatorëve energjetikë me fuqi nga 40 MVA si dhe ndërtimi i

linjës së dyfishtë kabllorike nëntokësore rreth 1.5 km dhe linjë ajrore 110 kV rreth 1.9 km gjatësi. Ndërtimi i NS Fushë Kosova me sistemin GIS dhe me dy transformatorë energjetikë do të fillojë me sigurimin e buxhetit, sipas punëve opcionale të përshkruara në kontratën bazë.

Komuna e Drenasit - Ndërtimi i Nënstacionit të ri NS 220/10(20) kV - Drenasi 2 me sistemin e stabilimenteve të teknologjisë moderne GIS, instalimi i 2 transformatorëve energjetik me fuqi nga 40 MVA si dhe ndërtimi i linjës së dyfishtë të tensionit të lartë 220 kV me gjatësi rreth 3 km.





Komuna e Therandës dhe Rahovecit – Rehabilitimi i NS 110/10(20) kV – Theranda me sistemin e stabilimenteve të teknologjisë moderne HIS dhe ndërtimi i linjës së re të tensionit të lartë 110 kV, NS Rahovec – NS Theranda në gjatësi rreth 19 km.



Gjatë muajve në vijim, KOSTT në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me mbështjen e komunave gjegjëse, do të realizojë përgatitjet e mëtutjeshme për fillimin e implementimit të projekteve. Do të organizohen debatet publike për vlerësimin e ndikimit në mjedis për projektet e lartcekura, përfundimin e procedurave të nevojshme për sigurimin e lejeve ndërtimore për objektet që konform ligjit vlerësohet se duhet siguruar, si dhe vlerësimet dhe realizimin e shpronësimeve dhe servituteve të nevojshme.



Komuna e Mitrovicës - Ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/10(20) kV – Mitrovica 2 me sistemin e stabilimenteve të teknologjisë moderne GIS, instalimi i 2 transformatorëve energjetikë me fuqi nga 40 MVA si dhe ndërtimi i dy linjave të dyfishta të tensionit të lartë 110 kV me gjatësi prej 2 km dhe 1.5 km.





## Delegacioni i KOSTT realizon vizitë pune në OST Shqipëri

**M**e ftesën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë, një delegacion i menaxhmentit të KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani realizuan vizitë pune njëditore në Tiranë. Në fokus të kësaj vizite ishte njoftimi i KOSTT me përgaditjet e gjertanishme të OST në drejtim të krijimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX), pjesë e së cilës planifikohet të jetë dhe KOSTT, si dhe diskutimi rreth hapave të metujeshëm bashkërendues. Me këtë rast z.Hasani, konfirmoi edhe një herë interesimin e KOSTT për të qenë pjesë e bursës shqiptare të energjisë si dhe falënderoi

administratorin e OST z.Engjëll Zeqo për përkrahjen e vazhdueshme. Në përfundim, të dy homologët u pajtuan për intensifikimin e takimeve dhe bashkëpunimit në drejtim të realizimit të projekteve/synimeve të përbashkëta të cilat janë në funksion të integritetit të tregjeve të energjisë si dhe sigurisë së furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike të të dyja vendeve. Delegacionet e KOSTT dhe OST gjithashtu u konsultuan rreth proceseve integruese në mekanizmat rajonal dhe evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit.



## KOSTT ndan mirënjohje për komunat që kanë kontribuar në implementimin e projekteve për zhvillimin e Sistemit Transmetues të Kosovës

Delegacioni i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, zhvilluan një takim me kryetarin e Komunës së Ferizajt z.Muharrem Sfarqa. Me këtë rast, z.Hasani njoftoi kryetarin Sfarqa rreth investimeve të gjertanishme të KOSTT në këtë komunë si dhe për planet për zhvillimin e metutjeshëm të infrastrukturës së transmisionit në vitet në vijim në mbështetje të zhvillimit ekonomik të kësaj komune.

Në anën tjetër, z.Sfarqa shprehu falënderimin e tij për investimet e vazhdueshme nga ana e KOSTT në ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit për qytetarët e komunës së Ferizajt dhe njëkohësisht shprehu zotimin për përkrahje në realizimin e projekteve të tjera të KOSTT.

Me rastin 10 vjetorit të themelimit të KOSTT, z.Sfarqa i'u dorëzua një mirënjohje për kontributin që ka dhënë Komuna e Ferizajt për ndarjen falas të

tokës komunale prej 4 hektarë për ndërtimin e Nënstacionit 400/110 kV Ferizaj 2.

Nënstacioni 400/110 kV Ferizaj 2, është një nga nënstationet më të rëndësishme të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës, në të cilin lidhet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Maqedoni. PP Ferizaj 2 është realizuar me bashkëfinancim të KOSTT me Qeverinë e Kosovës dhe fondet e Bashkimit Evropian në vitin 2011.



## Fillon zbatimi i prokurimit elektronik në KOSTT sh.a.



Prokurimi elektronik do të thotë blerje e shërbimeve dhe produkteve përmes platformës elektronike. Në mbështetje të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/79 të datës 15.03.2016 dhe vendimit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik nr.47/2016, nga fillimi i vitit 2017, ka filluar aplikimi i platformës së prokurimit elektronik për të gjitha autoritetet publike në Kosovë.

Qëllimi i prokurimit publik është që të siguroj vlerën më të mirë për paranë publike, duke respektuar rregullat që dalin nga Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë, derisa përdorimi i sistemit elektronik garanton një proces transparent dhe siguron kushtet

për një konkurrim të hapur ndërmjet operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

Në përputhje me vendimet e lartpërmendura, edhe KOSTT si kompani publike ka filluar me zbatimin e E-Prokurimit, nga janari i këtij viti. Në këtë proces përfshihen në mënyrë elektronike të gjitha procedurat e prokurimit publik me vlera të mëdha dhe të mesme dhe në pajtim me këtë, KOSTT sh.a përgatit dhe publikon në platformën elektronike të gjitha njoftimet dhe dosjet e tenderit për procedurat e prokurimit, siç janë paraparë me rregullat dhe Ligjin e Prokurimit Publik. Ndërsa të gjithë operatorët ekonomik që të kenë të drejtë pjesëmarrje në proceset e prokurimit elektronik, sipas ligjit janë të obliguar të regjistrohen në platformë.

Sipas vendimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), operatorët ekonomik mund të shkarkojnë dosjet përkatëse vetëm nga platforma elektronike ndërsa kanë të drejtë që të dorëzojnë ofertat e tyre qoftë në mënyrë elektronike apo edhe në atë fizike, por jo në të dy versionet, deri në funksionalizimin e plotë të prokurimit elektronik në fund të vitit 2017.

Deri më tani, KOSTT ka publikuar përmes platformës elektronike 12 procedura të prokurimit prej tyre, për shtatë procedura të prokurimit është realizuar me sukses hapja e ofertave në mënyrë elektronike, ndërsa është përmbyllur një aktivitet i prokurimit me njoftimin për nënshkrim të kontratës.

*Merita Zharku*

*u.d Drejtore e Departmentit të Prokurimit*



## KOSTT realizon vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Kroacisë – HOPS

Në funksion të bashkëpunimit rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese, një delegacion i KOSTT i udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Mustafë Hasani, së bashku me përfaqësuesit e projektit mbështetës të USAID (Repower Kosova), realizuan një vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Kroacisë (HOPS).

Në takimin i cili u realizua me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe HOPS në krye me drejtorin z. Miroslav Mesić,



u diskutua për çështje bilaterale që ndërlidhen me operimin e sistemit transmetues dhe operimin e tregut të energjisë elektrike.

Homologët nga Kroacia gjithashtu u njoftuan në lidhje me vështirësitë me të cilat po përballet KOSTT për integrim në mekanizmat ndërkombëtar si dhe u kërkua mbështetje për tejkalimin e sfidave në lidhje me implementimin e Marrëveshjes për Kyçje me ENSTO-E. Përfaqësuesit e HOPS shprehën interesimin për arsyet e mosimplementimit të marrëveshjes dhe njëkohësisht shprehën gatishmërinë për të përkrahur zbatimin e Marrëveshjes për Kyçje, në kuadër të kompetencave teknike dhe ligjore që kanë në rrjetin evropian të operatorëve të sistemit të transmisionit (ENTSO-E).

Në përmbyllje, z. Hasani falënderoi homologët kroat për bashkëpunim dhe vlerësoi gatishmërinë për përkrahjen e KOSTT-it për tejkalimin e sfidave aktuale në integrim në mekanizmat ndërkombëtar.



## Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 13 Prill 2017, në bazë të kërkesës të KOSTT, ka marrë vendim të aprovohet amandamentimi i dokumentit të Metodologjisë së Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit të KOSTT sh.a. (V\_912\_2017)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 13 Prill 2017, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a, përmes tarifave dhe ngarkesave për vitin relevant tarifor SHTE11. (V\_907\_2017)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 31 Mars 2017, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit "Plani Zhvillimor I Transmisionit 2017-2026". (V\_904\_2017)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur 23 Dhjetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim të i lejohet KOSTT-it derogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. (V\_879\_2016)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 23 Dhjetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike 2017-2026". (V\_878\_2016)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 23 Dhjetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit "Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2017". (V\_877\_2016)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 14 Tetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit "Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalanceve dhe çmimit të kompensimit". (V\_853\_2016)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 14 Tetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit "Rregulla për ndërrimin e furnizuesit". (V\_852\_2016)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 03 Tetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovohet amandamentimi i Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJJL, Versioni 1.4. (V\_851\_2016)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 03 Tetor 2016, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka marrë vendim për aprovimin e dokumentit "Derrogimet për Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut". (V\_850\_2016)

